

VENDIM
Nr.241, datë 27.2.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË
BULQIZË TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Bulqizë të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Bulqizë të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr.412, datë 9.6.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Bulqizë”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Bulqizë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Bulqizë
Lidhja 1

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-7	Prona që përdoren në fushën e arsimit.	Në pronësi
18-22	Prona që përdoren në realizimin e programeve sportive dhe kulturore.	Në pronësi
46(vetëm kati i parë i ndërtesës ish Sh.I.Sh)	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
48-51,64-76,77-90	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
56-63	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
54	Prona që përdoren për shërbim funeral.	Në pronësi
52,53	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
325,326	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë bujqësore).	Në përdorim
327,328	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë jobujqësore).	Në pronësi
359	Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza.	Në pronësi
331-357	Infrastrukturë vendore (rrugë, lulishte, trotuar, sheshe).	Në pronësi
55	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës (sheshe, troje, hapësira	Në përdorim

	publike).	
--	-----------	--